

01-892

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-111265/22 dt. 19.05.2022, të pronarit Gani Bajrami dhe investitorit “In Time” Sh.p.k. nga Suhareka me certifikatë të regjistrimit ARBK 810843822, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumë banesore me afarizëm, të ndërtuara në kuadër të tërësisë urbane “A12”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 05.07.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarit Gani Bajrami nga Prishtina, dhe investitorit “In Time” sh.p.k. nga Prishtina me certifikatë të regjistrimit ARBK 810843822, me përfaqësues Burim Bajraktari nga Suhareka, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-111265/22 dt. 19.05.2022, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht objekti 2 dhe 3 , me etazhitet B+P+4ET+NK, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-155470 dt. 18.08.2016, në kuadër të tërësisë urbane “A-12”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re- Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1568-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Malush Kosova” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 90, 92, 94 dhe 96 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Gani Bajrami nga Prishtina, dhe investitori “In Time” sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810843822, me përfaqësues Burim Bajraktari nga Suhareka, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-111265/22 dt. 19.05.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht objekti 2 dhe 3 , me etazhitet B+P+4ET+NK, të ndërtuara në kuadër të tërësisë urbane “A-12”, të Planit Rregullues Planit Rregullues “Prishtina e Re- Zona Qendër”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1568-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-155470 dt. 18.08.2016, të lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Njoftim”, me referencë 09 Nr. 391/02-124029/20 dt. 18.05.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e

Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e udhëheqësit të vendpunishtes Qendrim Bejtullahu; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Lumni Basha; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Halim Bajramaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Arban Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Xhavit Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Zenun Shala; Raportin e përfundimit të punëve të instalimit të pajisjeve për mbrojtje nga zjarri Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i Ejup Podvorica me nr. të licencës 207;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, instalimeve për mbrojtje nga zjarri, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-111265/22 DT. 05.07.2022**

Zyrtari,
Arbër Morina

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

Drejtori,
Arbër Sadiki

Faqe 2 prej 2

